

REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA KOSOVA

VENËDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROSEVAC

12.01.2017

Më
Data

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm,

Divizioni Penal, gjyqtari individual Hakile Ilazi me procesmbajtësen Nora Rushiti - Praktikante, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED], i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1625-4/15 të dt.30.08.2016, për shkak se ka kryer veprën penale asgjësim dëmtim ose heqja e instalimeve publike nga nen.366 par.2 lidhur me par.1 KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore PP/II.nr.1625-4/15 të dt.30.08.2016 për dhënien urdhrin ndëshkimor dënim me gjobë gjykata, me dt.14.11.2016 mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore PP/II.nr.1625-4/15 të dt.30.08.2016 gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED], nga fsh. [REDACTED] Komuna Shtime, i lindur më dt. [REDACTED] në Ferizaj, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me profesion vozitës, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike,.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 30.06.2015 rreth orës 17.20 në rrugën Rashincë – Suharekë, me të arritur afër servisit të automjeteve “ [REDACTED] ” në fsh. Muzeqinë, duke drejtuar automjetin – kamionin e firmës “ [REDACTED] ” nga pakujdesia ka dëmtuar instalimet publike i ka këputur telat e rrjetit elektrik, me ç rast ka shkaktuar çrregullim në furnizimin me energji elektrike,

Me të cilën kreu veprën penale asgjësimi dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga nen.366 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së

Gjykata në bazë të nenit 4,17,21,41,43,46, dhe 73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

G J Y K O N

Të pandehurin, me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

E dëmtuara [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësorë shumë prej 20 €, në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1625-4/15 të dt.30.08.2016, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] për veprën penale asgjësimi dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga nen.366 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së ë, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.1625-4/15 dt.30.08.2016, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës, vërtetojnë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpall fajtor dhe i shqipton dënimin sipas ligjit.

Gjykata në bazë të nenin 374 par.3 të KPRK-së konfiskon në mënyrë të përhershme substancën narkotike

I pandehuri është obliguar që të paguaj shpenzimet paushallin gjyqësor në shumë prej 20/ njëzet/€ konformë nenit 450 par 2.6 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.813/16 dt.14.11.2016

Procesmbajtësja
Nora Rushiti - Praktikante

Gjyqtarja Individuale,
Hakile Ilazi



UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim,
në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimin të aktgjykimit
të njëjtës gjykatë.